



KOMISARI I GARAVE

BULETINI

Nr. 59

6/25/2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 59-të e Komisarit të garave për edicionin 2018/19 mbajtur me 25.06.2019 në lokalët e FHK-së me fillim nga ora 12:00.

Rendi i ditës

I.	Pjesëmarrja e klubeve në arenën ndërkombëtare.....	2
II.	Fillimi i afatit të rregullt kalimtar për hendbollist dhe hendbolliste	3
III.	Fillimi i edicionit të ri të garave	3
IV.	Të ndryshme.....	3

I. Pjesëmarrja e klubeve në arenën ndërkombëtare

Bordi i FHK-së në bazë të vendimit të datës 25.06.2019 pasi shqyrtoi raportin e Komisarit të garave për klube të cilat e kanë fituar të drejtën të paraqiten në garat e Kupave të EHF-it për edicionin 2019/20 morri këtë:

VENDIM

- a) FHK-ja do të mbështet në rrethinë e parë të garave skuadrat kampione në të dy konkurrencat (KH BESA FAMGAS dhe KHF ISTOGU) duke ju paguar këto shpenzime:
- Transportin në udhëtim (Autobusin apo biletat e aeroplanit (varët nga largësia e vendit të zhvillimit të ndeshjes) i siguron FHK-ja për 18 persona sipas Rregullores së EHF-it për garat e Kupave të EHF-it).
 - Akomodimin e personave zyrtarë (gjyqtarëve dhe delegatit).
 - Transportin e personave zyrtarë (në bazë të biletave që i sjellin personat zyrtarë, apo në rastin tjetër i rezervon dhe i siguron FHK-ja).
 - Obligohen skuadrat që çdo korrespondencë me klubet lidhur me zhvillimin e ndeshjeve ta informojnë edhe FHK-në, sidomos kur kemi të bëjmë me zhvillimin e dy ndeshjeve në një vend, në të kundërtën FHK-ja nuk merr obligime. Korrespondencat me email duhet të adresohen (CC) edhe tek FHK-ja në adresën elektronike: office@kosovahandball.info
 - Skuadrat janë të obliguara që në fanellat e ndeshjes të kenë logon e FHK-së.
- b) Skuadrat pjesëmarrëse në CHALLENGE CUP për edicionin 2019/20 në të dy konkurrencat nga FHK-ja do të mbështeten nga 2000 €.
- Klubet KH Kastrioti, KH Prishtina, KH Vëllaznimi, KHF Vushtrria, KHF Prishtina dhe KHF Shqiponja për tu regjistruar për pjesëmarrje në garat e Challenge CUP duhet të kenë edhe garancinë për përkrahje financiare nga Komuna nga përkatëse me shkrim (Memorandum apo Marrëveshje).
 - Obligohen skuadrat që çdo korrespondencë me klubet kundërshtarë lidhur me zhvillimin e ndeshjeve ta informojnë edhe FHK-në, sidomos kur kemi të bëjmë me zhvillimin e dy ndeshjeve në një vend, në të kundërtën FHK-ja nuk merr obligime. Korrespondencat me email duhet të adresohen (CC) edhe tek FHK-ja në adresën elektronike: office@kosovahandball.info .
 - Skuadrat janë të obliguara që në fanellat e ndeshjes të kenë logon e FHK-së.

- c) Çdo faturë e cila kalon shumë mbi 500 euro duhet të bëhet me transaksion bankar si dhe të ketë kontratë.

VËREJTJE DHE UDHËZIME:

- Klubet duhet deri më datën 01 Korrik 2019 të përmbushin formularin e regjistrimit (formulari përmban të dhënat mbi klubin i cili vërtetohet edhe nga zyra e FHK-së)
- Më 09 korrik publikohet lista e kundërshtarëve të mundshëm
- Më 19 korrik tërheqja e Shortit

Të bashkangjitur e keni edhe formularin e regjistrimit i cili duhet të plotësohet deri me datën 01 korrik 2019, i cili duhet të ketë edhe Memorandumin apo marrëveshjen nga Komuna nga vijnë klubet.

II. *Fillimi i afatit të rregullt kalimtar për hendbollist dhe hendbolliste*

Bordi i FHK-së në bazë të vendimit të datës 25.06.2019 në mbështetje të Rregullores mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve, satusin, transferimin e tyre propozon që Afati i rregullt kalimtar për edicionin 2019/20 të fillon më 1 dhe të përfundon me 15 korrik 2019.

Lojtarët që marrin statusin e lire gjatë afatit kalimtar mund të regjistrohen për klubet e reja deri më 15 tetor 2019.

Lojtarët që vijnë nga bota e jashtme mund të regjistrohen edhe pas afatit kalimtar deri me 28 shkurt 2020.

Lojtarët nën moshën 23 vjeçare edhe pse nuk kanë kontratë me klube vlen të Rregullorja mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve, satusin, transferimin e tyre përkatësisht neni 64 dhe 65 i kësaj Rregulloreje.

III. *Fillimi i edicionit të ri të garave*

Bordi i FHK-së në bazë të vendimit të datës 25.06.2019, informon klubet, se data e fillimit të edicionit të ri të garave në Superligën e meshkujve dhe femrave do të jetë 14/15 shtator 2019.

IV. *Të ndryshme*

1. Komisari i garave për shkaqe teknike në Buletinin e radhës (Buletinin nr.60) do të përgatit dhe do të bashkëngjis të gjitha statistikat e Klubeve, lojtarëve dhe delegimet e personave zyrtar.
2. Klubet, lojtaret të cilat nuk i kanë përmbushur obligimet nga FHK-se janë të obliguar paraprakisht që para fillimit të edicionit të ri të përfundojnë ato në të kundërtën nuk do të mund të licencohen.

Istref SADRIU
KOMISAR I GARAVE d.v